


 Universiteti i Prizrenit Univerzitet Prizrena Prizren Üniversitesi "UKSHIN HOTI" FAKULTETI JURIDIK	
Pranuar me dt. <i>26.07.2022</i>	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
<i>410</i>	<i>03/185</i>



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

Memorandum Bashkëpunimi
në mes të
Fakultetit Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren
dhe
Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD)

Prizren, korrik 2022

Në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren dhe ligjin e aplikueshëm në Kosovë, Fakulteti Juridik i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi, lidhin këtë Memorandum Bashkëpunimi:

Neni 1

Qëllimi i bashkëpunimit

1. Fakulteti Juridik i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren (*tani e tutje “Fakulteti Juridik”*) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi (*tani e tutje “IKD”*), pajtohen për të bashkëpunuar në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisve respektive si dhe duke pasur parasysh fushëveprimin që kanë, sipas akteve të tyre në fuqi.
2. Bashkëpunimi në mes të Fakultetit Juridik dhe IKD-së do të përfshijë por nuk do të kufizohet në shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës reciproke në fushën e drejtësisë, duke përfshirë çështjet penale, civile dhe administrative, si dhe praktikën gjyqësore.
3. Fakulteti Juridik përmes ekspertizës së stafit akademik, do të ofrojë përkrahje duke marrë pjesë në aktivitete të IKD-së, që për qëllim kanë përmirësimin e sundimit të ligjit, përkatësisht përmirësimin e zbatimit të drejtë të instituteve të së drejtës.
4. Fakulteti Juridik përmes pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete dhe projekte të IKD-së, do të ndihmojë ngritjen e kapaciteteve të juristëve të rinj për fushat në të cilat IKD ka ekspertizë dhe zhvillon aktivitete dhe projekte të ndryshme.
5. IKD, sipas nevojës do të kërkojë ekspertizën e stafit akademik të Fakultetit Juridik, në kuadër të projekteve që i zbaton si dhe do të përfshijë studentët e Fakultetit Juridik, në kuadër të programeve që ofron.

Neni 2

Misioni dhe vlerat e Fakultetit Juridik

1. Fakulteti Juridik në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren, si institucion i Arsimin të lartë. Misioni dhe objektivat Fakultetit Juridik përfshijnë por nuk kufizohen në: Ofrimin e programeve studimore sipas standardeve ndërkombëtare përfshirë edhe programet e studimit në gjuhën shqipe dhe të komuniteteve. - Edukimin e studentëve dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës, në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, punës sociale, administratës publike dhe financave publike, - Themelimin e Institutit për Studime Juridike dhe Politike, - Themelimin e Zyrës për studime Klinike - Themelimin e qendrës për zhvillimin e karrierës, - Themelimin e bibliotekës digjitale, - Hapjen e programeve të reja Master dhe Doktoraturë, - Shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve. - Rritja e ndjenjës së vullnetarizmit për Staf dhe studentë.

2. Vlerat e Fakultetit Juridik ndërlidhen me Avancimin e dijes, mendimit kritik dhe veprimeve kreative; Kultivimin e një shoqërie demokratike, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe diversitet multikulturor duke pasur parasysh bashkëjetesën e kulturave të ndryshme në Prizren me rrethinë si dhe krijimin e juristëve të rinj, të gatshëm për tregun e punës.

Neni 3

Misioni dhe përgjegjësitë e IKD-së

1. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) është organizatë e pavarur joqeveritare dhe jofitimprurëse, fabrikë e mendimeve e specializuar në fushën e drejtësisë, që merret me avancimin e së drejtës. Misioni i IKD-së është forcimi i sundimit të ligjit dhe përmirësimi i qasjes në drejtësi për qytetarët. Veprimtarinë e vet, instituti zhvillon përmes tetë (8) programeve kryesore:
 - a. Bërja e Ligjit
 - b. Sundimi i Ligjit
 - c. Qasja në Drejtësi
 - d. Antikorrupsioni
 - e. Edukimi
 - f. Media
 - g. Qeverisja e mirë
 - h. Drejtësia në zgjedhje.
2. Programi “Edukimi” është qëllim institucional i IKD-së, i shndërruar në program të veçantë, në të cilin përfshihet edukimi profesional që ofrohet për prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët, pastaj edukimi i juristëve të rinj përmes programit të Klinikës Ligjore dhe punës praktike, si dhe trajnimet e punëtoritë e shumta profesionale. Në kuadër të këtij programi, edukohen edhe gazetarët e rinj, të cilët inputet kryesore i japin në kuadër të programit Media.

Neni 4

Mënyra e bashkëpunimit

1. IKD do të ofrojë bashkëpunim dhe mbështetje për Fakultetin Juridik, përmes trajnimeve të specializuara për studentë lidhur me zbatimin në praktikë të drejtësisë penale, civile dhe administrative, duke përfshirë organizimin e ligjëratave dhe punëtorive, monitorimin e seancave gjyqësore dhe paraqitjen e kërkesave për qasje në dokumente publike.
2. Fakulteti Juridik dhe IKD do të organizojnë aktivitete të përbashkëta për të ngritur vetëdijesimin lidhur me fenomene dhe tema të caktuara në fushën e sundimit të ligjit, duke organizuar tryeza, konferenca dhe debate televizive, varësisht nga mundësitë dhe projektet në zbatim nga IKD.

3. Fakulteti Juridik do t'iu mundësojë studentëve, juristë të rinj, që të zhvillojnë kapacitetet e tyre profesionale përmes mundësisë së punës praktike në IKD (me ose pa pagesë, varësisht nga projektet në zbatim). Në këtë mënyrë, Fakulteti Juridik do të ofrojë listën e studentëve të suksesshëm dhe të interesuar, të cilët mund të përfitojnë nga puna praktike në kuadër të programeve të IKD-së. Procedurën përzgjedhëse të studentëve, për pjesëmarrje në programet e IKD-së, e zbaton Fakulteti Juridik.
4. Varësisht nga nevoja dhe mundësitë, Fakulteti Juridik dhe IKD do të gjejnë edhe forma të tjera të bashkëpunimit, gjithnjë duke i pasur parasysh aktet e tyre të brendshme dhe programet në zhvillim që i kanë të dyja palët në këtë memorandum.
5. Fakulteti Juridik dhe IKD, do të ndihmojnë njëra tjetrën në përmbushjen e misionit, vizionit dhe promovimit të vlerave të tyre.
6. Fakulteti Juridik dhe IKD do të caktojnë personin përgjegjës dhe kontaktues, për zbatimin e këtij memorandumi.

Neni 5 Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit është përgatitur me pëlqimin e të dyja palëve me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjellët.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të jetë në fuqi në kohë të pacaktuar, derisa palët nuk vendosin ndryshe.
3. Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të plotësohet apo ndryshohet me pajtimin e të dyja palëve.

Për Fakultetin Juridik



Prof. Asoc. Dr. Kadri Kryeziu
Dekan

Për Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD)



Ehat Miftaraj
Drejtor Ekzekutiv